

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjendet i vdekur në Londër nipi i Princeshës Katerina, i hetuar si i dyshuar për rastin “Putney Pusher
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/gjendet-i-vdekur-ne-londer-nipi-i-princeshes-katerina-i-hetuar-si-i-dyshuar-per-rastin-putney-pusher/1014610/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:41:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:40:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	11bfeb16be8ff3023e979b52b6f10f8fc44f1c22b27ed6c0e506587d8ec61b58
TEKSTI	bb1bb39811f5deb61b7bf86aa73e3bc29f15f7d96e675a112c629dc212b409af
PAMJA	6bdec2fab8d56edf8f923c2c303ab7d8200cdc2f0cef2ac04818b680b831dc6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1c227dc9e90ec8f0b61a62581d1370803b75ca63c4beef7bb689f313bb95dbeb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1c227dc9e90ec8f0b61a62581d1370803b75ca63c4beef7bb689f313bb95dbeb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjendet i vdekur në Londër nipi i Princeshës Katerina, i hetuar si i dyshuar për rastin “Putney Pusher”



Nicholas Brandram, 44 vjeç, nipi i Princeshës Katerina të Greqisë dhe Danimarkës, u gjet pa jetë në banesën e tij në Chiswick, në zonën perëndimore të Londrës.

Policia Metropolitane njoftoi se Brandram ishte gjetur pa ndjenja në shtëpinë e tij në mbrëmjen e së martës, më 15 shtator. Shërbimi i Ambulancës së Londrës dhe policia shkuan në adresë rreth orës 19:12, por 44-vjeçari u shpall i vdekur.

“Të afërmit e tij janë informuar. Në këtë fazë, vdekja e tij po trajtohet si e papritur, por nuk ka rrethana të dyshimta”, deklaroi Policia Metropolitane.

Më herët, identiteti i Brandram nuk ishte bërë i njohur për publikun, ndërsa autoritetet po hetonin rrethanat e vdekjes së tij. Pas vdekjes, policia lejoi që emri i tij të bëhej publik.

Brandram kishte qenë pjesë e hetimeve për një nga ngjarjet më të përfolura të viteve të fundit në Londër, e njohur si “Putney Pusher”.

Në maj të vitit 2017, kamerat e sigurisë në Urën Putney regjistruan një burrë që vraponte dhe që shtyu një grua në trotuar, pikërisht në momentin kur po afrohej një autobus. Shoferi reagoi në kohë dhe arriti ta shmangte gruan, e cila i shpëtoi një përplasjeje të mundshme me autobusin.

Pamjet u bënë virale në Britani dhe autori i panjohur u quajt nga mediat me nofkën “Putney Pusher”.




të fundit /



Gjendet i vdekur në Londër nipi i Princeshës Katerina, ...



Kroacia: Aktgjykimi i Hagës nuk e zhbën të vërtetën historike, ...



Sot më dhemb Kosova” – Nga Luiz Ejlli te Elvana Gjata, të...



Gurë mbi objektin e Qeverisë së Kosovës, protestuesit thyejnë...



Richard Grenell reagon ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Hagës



Pas vendimit të Speciales, Altin Krasniqi viziton të ati...



Daçiq: Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së përforcon qëndrimin ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium



Pavarësisht viteve të hetimeve, identiteti i personit që shfaqej në pamjet e kamerave nuk ishte përcaktuar në mënyrë përfundimtare. Brandram u hetua si i dyshuar në këtë çështje.

Hetimi fillestar u mbyll në vitin 2018, pasi ndaj askujt nuk u ngrit asnjë akuzë. Megjithatë, informacione të reja çuan në arrestimin e Brandram gjatë kësaj vere. Vetëm javën e kaluar, detektivët njoftuan se ai ishte liruar me kusht, ndërsa hetimet vijonin.

Nicholas Brandram ishte djali i Paul Brandram, fëmija i vetëm i Princeshës Katerina të Greqisë dhe Danimarkës dhe i Major Richard Campbell Andrew Brandram, i cili shërbeu në Ushtrinë Britanike gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Princesha Katerina, e lindur më 4 maj 1913, ishte stërmbesë e Mbretëreshës Viktoria dhe kushërirë e parë e Princit Filip. Ajo ishte fëmija i gjashtë dhe vajza e tretë e Mbretit Konstandin I të Greqisë dhe Sofisë së Prusisë, si dhe motër e tre mbretërve grekë dhe e një mbretëreshë të Rumanisë.

Pas pushtimit gjerman të Greqisë në vitin 1941, Katerina u largua nga vendi së bashku me vëllanë e saj Palin dhe bashkëshorten e tij, Frederikën. Ajo kaloi fillimisht në Kretë, më pas në Egjipt dhe në Afrikën e Jugut, ku punoi si infermiere në një spital në Kejptaun.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ajo u kthye në Angli dhe në vitin 1947 u martua me Major Richard Brandram, një ish-lojtar regbie. Çifti ishte takuar në anijen HMS Askania, gjatë kthimit nga Aleksandria drejt Anglisë.

Edhe Nicholas Brandram ndoqi një karrierë në botën e financave. Ai punoi në kompaninë e ndërmjetësimit Killik & Co dhe në bankën izraelite Bank Leumi, përpara se të kalonte në HSBC, ku merrej me menaxhimin e pasurive të individëve të pasur.

Përveç karrierës në sektorin financiar, Brandram kishte shërbyer edhe si kapiten në Ushtrinë Britanike, me misione në Irak, Bosnjë dhe Afganistan.

Shtuar më 16.09.2026 16:40



Tragjedi në një minierë ari në Sudan, 60 viktima dhe persona të tjerë nën rrënoja



BE-ja propozon një partneritet të ri me Kanadanë, von der Leye...




Zelensky dyshon se Rusia e dinte vendndodhjen e tij, teksa dronët iu afruan...



Rusia synon të minojë identitetin evropian, paralajmëron Von der...



Von der Leyen: Deficiti tregtar me Kinën arrin 1



Sulmet me dronë pranë kufijve të NATO-s, Polonia



Rritja e çmimeve të karburanteve, Merz pranon:



Shtohen anijet e bllokuara në Hormuz, SHBA raporton

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

[Live tv shqiptare](#)
[Moti në Shqipëri](#)
[Travel](#)
[Horoskopi](#)
[Livescore](#)
[News from Albania](#)

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë